

**RAPORT PËR KUVENDIN E SHOQATËS
"KOMUNITETI SHQIPTAR I GJENEVËS" MBI
KONTROLLIN E KONTOS PËR VITIN 2024**

Sipas autorizimeve që na janë dhënë në kuvendin e mbajtur me 10 tetor 2024 ne kemi ndërmarrë, në bazë të dokumenteve të paraqitura, kontrollin e llogarive të shoqatës për periudhën 1 janar 2024 gjer më 31 dhjetor 2024.

Pas kontrollit të bërë ne vërtetojmë se llogaritë e shoqatës Komuniteti Shqiptar i Gjenevës për vitin 2024 janë korrekte. Bilanci shënon një vlerë prej **22'857'11** fr.

Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve shënon një rezultat **pozitiv** prej **3'094'82** fr. Ky rezultat pozitiv vjen nga anëtarësia, donacionet dhe manifestimet.


Ne kemi konstatuar se bilanci dhe llogaria e fitimit / humbjes përputhet me kontabilitetin. Verifikimi i bërë na ka mundësuar të konstatojmë saktësinë e kontabilitetit dhe ekzistimin e të gjitha pjesëve që vërtetojnë çdo operacion të verifikuar.

Si përfundim, ne i rekomandojmë Kuvendit të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës të miratojë llogaritë e paraqitura.

Në Gjenevë, me 4 tetor 2025

Verifikuesit e kontos

Shaip Deda



Mejreme Terziu Ibrahim



Përparim Bytyqi

